

Projektligj, akt normativ, projektvendim për strukturën e ILD-së

Datë 21/12/2020

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në drejtimin e kryetarit z.Ulsi Manja dhe në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e radhës shqyrtoi dhe miratoi një projektligj, një akt normativ, një projektvendim për strukturën e ILD-së, si dhe zhvilloi një seancë dëgjimore me 5 kandidaturat për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Të pranishëm për prezantimin e projekt-aktit ishin znj. Dajna Sorensen, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, z. Astrit Hado, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe staf teknik i MFE-së. Znj. Sorensen sqaroi se Akti Normativ shton një dispozite të vetme me efekt të menjëhershëm që parashikon trajtimin e veçantë financiar për familjen e personit që ka humbur jetën aksidentalisht nga veprimet e punonjësve të agjencive ligjzbatuese në vend. Sipas zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë personi përfitues dhe masa e pensionit do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Pas diskutimeve komisioni miratoi Aktin Normativ në fjalë dhe ia kaloi për miratim seancës plenare.

